

URDHËR
Nr. 257, datë 2.5.2023

**PËR DISA SHITESA NË URDHRIN NR. 651, DATË 31.12.2021, “PËR MIRATIMIN E
FORMATEVE TË PROTOKOLL KONTROLLEVE QË KRYHEN NGA
VETERINERI ZYRTAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 5 të nenit 131, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e shtojcës 11, në urdhrin nr. 651, datë 31.12.2021, “Për miratimin e formateve të protokoll kontrolleve që kryhen nga veterineri zyrtar”.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Vetërnarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË
BIMEVE
DREJTORIA RAJONALE E VETERINARISË DHE MBROJTJES SË
BIMËVE

Nr _____ Prot.

Datë ____/____/2023

PROTOKOLL KONTROLLI

(Listë verifikimi)

“PËR

PLOTESIMIN E KUSHTEVE SANITARO-VETERINARE NË SUBJEKTET E
VEPRIMTARISË “PËR TREGËTIMIN E KAFSHËVE TË SHOQËRIMIT”

Shtojca 11

Bazuar në nenin, 30, pika 1, germa “c”, nenin 51, 73, 74, 76, 76, 131, germa ë, i, nj, q, rr , si dhe neni 134 të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe ligjit nr.10433, datë, 16.6.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,

Motivi i hartimit

- ☐ Për plotësimin e kushteve sanitaro-veterinare për licensim (QKB).
- ☐ Për kontrollin/inspektimin e programuar ose për inspektimin jashtë programit, të planifikuar.

Subjekti/ objekt i tregëtimit të kafshëve të shoqërimit _____

Vendi/ Adresa: / Rrethi _____/Bashkia _____ / Qarku _____

Përfaqësuesi ligjor/ administratori, Z/ Znj _____

Sipërfaqja e subjektit : _____m²

Nr. Tel _____ / E-mail _____

Nr i veçantë i aprovuar: _____ AL/00/Kodi i Rrethit nga RUDA / 000, nr. aprovuar, i
serisë në regjisterin e autoritetit kompetent (*psh AL01/001*)

Shërbimi veterinar rajonal në DRVMB: _____

• **TIPI i OBJEKTIT**

- Dyqan i kafshëve të shoqërimit (tregëti me shumicë/pakicë) ☐ Po ☐ Jo
- Dyqan mbarshtimi për kafshët e shoqërimit ☐ Po ☐ Jo

DOKUMENTACIONI I PROVUES I SUBJEKTIT

Baza ligjore	Dokumentacioni Provues për aktivitetin	Vlerësim		VREJTJE Shëno të dhëna të kërkuara/ kostatuara
		Po	Jo	
1. Ligji nr.10465, datë, 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar, neni 137; 2. Ligji nr.10081, dt.23.2.2009 “Për Licencat Autorizimet, dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, sipas Shtojcës , “fusha II”; 3. VKM, nr.538, dt.26.5.2009. “Për licensat, lejet që trajtohen nëpërmjet QKB dhe disa rregullave të tjera, nën ligjore të përbashkëta”, Kategoria II.3 “Rritja dhe Tregtimi i kafshëve”, pika 2, germa “c”, 4. Ligji nr.10433, dy.16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.	Dokumenti i QKB			
5. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-4.	Plan vendosje e subjektit të miratuar nga KKRT,			
6. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-4.	Dokumenti i pronësisë, ose kontrata e pronësisë ose e qirasë së dyqanit të kafshëve të shoqërimit.			
7. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-4.	Mjeku veteriner i certifikuar për tregëtimin e kafshëve të shoqërimit (dëshminë e kualifikimit) dhe i regjistruar në UPMV . Në këtë rast, pronari ose kontrata me mjekun veterinar, të punësuar.			

A- TË DHËNA TË PËRGJITHËSHME

- Rrugët e shkarkimit të ujit Po ☐ Jo ☐
- Furnizimi me ujë: rrugët -rrjeti hidrik Po ☐ Jo ☐
- Impiant qëndror për furnizimin me ujë të ngrohtë Po ☐ Jo ☐

B-KUSHTET SANITARO-VETERINARE PËR SUBJEKTET E TREGËTIMIT TË KAFSHEVE TË SHOQËRIMIT

Baza ligjore	Kushtet sterukture dhe higjieno, sanitaro-veterinaro që zbatohen në ambjentet e tregëtimit të kafsheve të shoqërimit	Vlerësimi		VREJTJE Shëno të dhëna të kërkuara/ kostatuara
		Po	Jo	
1. Kreu IV, Seksioni 1, neni 65, 66, i Ligjit, nr.10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; 2. Udhëzimi Nr. 22, dt, 25.11.2010, “Për kushtet e përgjithëshme dhe të veçanta , të higjienës, për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor	Hapësira të domosdoshme në sipërfaqe për ushtrimin e veprimtarisë normale të punës: - dyqan jo më të vogël se 30 m ²			
3. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	Struktura e godinës së tregëtimit, me material, solid të qëndrueshëm, jo koroziv e të papërshkueshëm nga lagështira,			
4. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	sigurohet ndarja fizike e ambjenteve të punës të ndara nga ambjentet e tjera për: - ambjentin (zyra), për pritjen e pronarëve të kafshëve të shoqërimit, personave fizik apo juridik, për tregëtimin e kafshëve të shoqërimit;			
5. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-si dhe ambjentin për mbajtjen dokumentacionit detyrues, të blerjeve dhe shitjeve të kafshëve të shoqërimit (regjistrat, certifikatat e lëvizjes së kafshëve të shoqërimit, etj).			
6. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-Ambjenti për mbajtjen e kafshëve të shoqërimit.			
7. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	Ambjentet e shërbimit sanitar			
8. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-dyshmeja e dyqanit me material të qëndrueshëm, jo koroziv, funksionale dhe lehtësisht e pastrueshme dhe e dizinfektueshme.			

9. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-tavanet me material të qëndrueshëm dhe solid.			
10. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-dyert me strukturë të qëndrueshme të pa përshkueshme, që lahen dhe dizinfektohen.			
11. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-rrjeta mbrojtëse në dritare kundër insekteve.			
12. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-ajri i përshtatshëm dhe i ventilueshëm.			
13. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-Ndriçim natyral dhe artificial.			
14. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-sigurohet hyrja e personave të pa autorizuar në objekt.			
15. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-dhoma e garderoabës për personelin si dhe tualeti.			
16. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-mjetet teknike sanitare, të mbrojtjes në punë, pajisjet zjarrfikëse .			
17. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 1-2.	-hapësirat e dyqanit, të mbrojtura nga drita direkte e diellit, nga lagështira dhe të ketë temperatura normale dhe të jenë të kondicionuar.			
2. Neni 66, 73, 74 dhe 76 i Ligjit Nr.10465 dt 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.	Kërkesat/ kushtet që zbatohen nga pronari i tregëtimit (dyqanit) të kafsheve të shoqërit			
2.1. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	T'u sigurojë kafshëve lëvizjen e nevojshme në ambjentet e dyqanit.			
2.2. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Të sigurojë që kafshët në ambjentet e dyqanit, nuk mbarështohen në errësirë të plotë dhe të përhershme ose të lidhur gjithë kohës.			
2.3. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Të sigurojë që kafshet të mos mbahen në hapsira të ngushta dhe strehime me lloje të tjera të kafshëve të papajtuësme me njëra-tjetrën ose të kafshëve të të njëjtit lloj, të cilat mund të çojnë në rritje të agresivitetit, stresit dhe tensionit;			
2.4. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Të sigurojë vendin, kushtet dhe një mikroklimë të përshtatshme të qëndrimit, në përputhje me nevojat e kafshës, si dhe hapësirën e nevojshme të shtrirjes dhe akomodimit dhe lirinë e lëvizjes.			
2.5. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Të sigurojë ushqim dhe ujë në sasi të mjaftueshme dhe qasje të lirë në vendet ku ushqehet dhe pi ujë.			

2.6. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Të sigurojë pajisje të përshtatshme për ushqim dhe pirjen e ujit, të vendosura në mënyrë që të shmangin kontaminimin e tyre, dëmtimet e streset dhe të ulin në minimum konkurrencën agresive mes kafshëve.			
2.7. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Të sigurojë që kafshët e mbajtura në mjediset e lokaleve të mos paraqesin rrezik për jetën e njerzëve.			
2.8. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Të parandalojnë riprodhimin e pa dëshiruar të kafshëve të shoqërimit, duke vlerësuar veçoritë e tyre fiziologjike, anatomike dhe të sjelljes			
2.9. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Të mbajnë paster ambjentet e dyqanit dhe të mbajnë regjister të dezinfektimit të ambjenteve të tyre.			
2.10. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 2.	Janë të detyruar të sigurojnë për zbatimin e rregullave të mbrojtjes dhe mirëqenies së kafshëve .			
3. Neni 12, 51 dhe 66 i Ligjit nr.10465 dt 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.	Dokumentacioni i mbajtur në subjektin e tregëtimit të kafshëve të shoqërimit			
3.1. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 3.	Kafshët të jenë të pajisura me pasaportë mjekësore veterinare brenda 6 javëve nga lindja, ku janë të shënuar vaksinimet dhe trajtimet mjekësore dhe anti parazitare të lëshuar nga një klinikë ose spital veterinar i licensuar.			
3.2 Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 3.	Kafshët që tregetohen duhet të jenë të identifikuar sipas legjislacionit në fuqi, brenda 14 ditëve nga lindja.			
3.3. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 3.	Regjistrat tip të miratuar, të hyrjeve dhe daljeve të kafshëve të blera dhe të shitura			
3.4. Legjislacioni sipërcituar, sipas pikës 3.	Regjistrin tip të miratuar të trajtimeve me PMV-të e përdorura.			

C-KUSHTET HIGJENO – SANITARE DHE TRAJNIMI I STAFIT

- Dhoma (garderobera) për punonjësit: Po ☐ Jo ☐
- Veshje pune për punonjësit: Po ☐ Jo ☐
- Librezat shëndetsore të personelit: Po ☐ Jo ☐
- Trainimi i stafit: Po ☐ Jo ☐

Shënime:

Rekomandime mbi gjetjet e kostatuara

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

6. _____

Afati i masës

- Ky protokoll është i detyrueshëm të mbahet jo më pak se 2 herë në vit për çdo subjekt të regjistruar dhe të monitoruar nga sektori i shërbimit veterinar në DRVMB. Në rast të problematikës të hasur dhe vlerësimit të riskut frekuenca e inspektimit/kontrollit rritet nga autoriteti kompetent (AKVMB).

- Ky dokument mbahet në 5 kopje: kopja origjinale mbahet nga veterineri zyrtar, një kopje i dorëzohet subjektit, një kopje, qëndron në sektorin veterinar të DRVMB-së dhe një në AKVMB. Kopja e pestë shoqëron dokumentacionin për licensim, që përcillet nga i AKVMB në ministri.

- Protokoll- kontrollet e mbajtura dorëzohen nga AKVMB-ja brenda 5 ditëve në MBZHR, nga dita e inspektimit, në rastin kur ky protokoll- kontroll është i hartuar për miratimin e licencës të subjektit që kryen aktivitet tregëtar në fushën e veterinarisë. Ky protokoll (*listë verifikimi*) shoqëron dokumentat standarte të procedurës së inspektimit të AKVMB.

Për sa mësipër nënshkruhet nga:

**Përfaqesuesi i subjektit të tregëtimit
të kafshëve të shoqërimit**

(emër mbiemër firma)

Grupi i inspektimit ose kontrollit

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____
(emër mbiemër firma vula)